

Deutschcolor sh.a



## Projekti Teknik

Aktiviteti: Industria kimike “Prodhimi i bojërave dhe llaqeve” të subjektit DEUTSCHCOLOR Sh.a



Me vendndodhje ne: DURREËS, Maminas, Vlashaj, Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796.

Pergatitur nga A Consultant Sh.p.k  
Qershor 2018



Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj, Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconultantal@gmail.com](mailto:aconultantal@gmail.com) ; web:  
[aconultant.com.al](http://aconultant.com.al) dhe Cel: 0696032083

## Permbajtja

1.1	Pershkrimi i projektit.....	4
1.2	Informacion mbi Subjektin Deutschcolor Sh.a .....	4
2.	PLANIMETRIA E VENDNDODHJES SË PROJEKTIT .....	5
2.1.	Vendodhja e projektit: .....	5
2.2.	Zonat e banuara .....	9
3.	INFORMACIONI PËR QENDRAT E BANUARA NË ZONËN KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI,.....	11
3.1.	Popullata dhe demografia e Republikës Shqiptare:.....	11
3.2.	Popullata dhe demografia e Durrësit.....	13
3.3.	Aktivitetet Ekonomike përfshi aktivitetet kryesore që zhvillohen.....	17
4.	SKICAT/PLANIMETRITË E OBJEKTEVE/STRUKTURAVE TË PROJEKTIT; .....	21
4.1.	Pershkrimi i vendndodhjes së instalimit.....	21
5.1.	Pershkrimi dhe organizimi i punës për aktivitetin “Prodhimi i bojërave dhe llaqeve” .....	29
6.	INFORMACIONI PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME .....	38
6.1.	Lidhja e zonës me rrugë.....	38
6.2.	Lidhja me rrjetin elektrik.....	38
6.3.	Furnizimi me ujë .....	39
6.4.	Sistemi i kanalizimit të ujrave të përdorura .....	40
6.5.	Rrugët ekzistuese.....	40
7.	PROGRAMI PËR NDËRTIMIN, FUNKSIONIMIN DHE MBYLLJEN E PROJEKTIT; ..	41
	<b>Masa rehabilituese pas përfundimit të aktivitetit</b> .....	43
8.	MËNYRAT DHE METODAT QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË PROJEKTIT; .....	43
8.1	Makinërit dhe pajisjet .....	43
9.	INFORMACIONI PËR LIDHJET E MUNDSHME TË PROJEKTIT ME PROJEKTE TË TJERA EKZISTUESE PËRRETH/PRANË ZONËS SË PROJEKTIT; .....	46
9.1	Perputhshmëria me planin e territorit.....	47
10.	INFORMACIONI PËR ALTERNATIVAT E MARRA NË KONSIDERATË PËR SA I TAKON PËRZGJEDHJES SË VENDNDODHJES SË PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË QË DO TË PËRDORET; .....	49
11.	TË DHËNA PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, ENERGJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE; .....	51
13.	AKTIVITETE TË TJERA QË MUND TË NEVOJITEN PËR ZBATIMIN E AKTIVITETIT.....	55
12.1	Parkimi i mjeteve.....	55
12.2	Zyrat e kompanisë .....	55
12.4	Ambientet e higjenes dhe të kujdesit personal .....	57

**Deutschcolor sh.a**



13.	INFORMACIONI PËR LEJET DHE LICENCAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN/LICENCIMIN E PROJEKTIT.....	58
13.1	Referenca ne kuadrin e percaktimeve Shqiptare dhe Nderkombetare. ....	58
14.	KONKLUZIONE.....	63

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al) dhe Cel: 0696032083

## **1. PËRSHKRIMI I QËLLIMIT TË PROJEKTIT TË PROPOZUAR;**

### **1.1 Pershkrimi i projektit.**

Subjekti Deutschcolor sh.a sjell në Shqipëri traditën Gjermane 100-vjeçare në prodhimin e bojërave për ambiente të brendshme dhe të jashtme.

Ne kuader të zgjerimit të gamës së produkteve që tregton dhe të kapaciteteve prodhuese, subjekti ka ndertuar një objekt dhe do të instalojë fabrikën e re për prodhimin e bojërave dhe llaqeve me vendndodhje në Durrës, Maminas, Vlashaj, Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796.

Aktualisht subjekti e ka të ndertuar objektin ku do zhvillojë aktivitetin fabrika si dhe është duke montuar dhe koaliduar linjat dhe pjesët përberëse të fabrikës për prodhimin e bojërave.

Linjat teknologjike të instaluar për funksionimin e aktivitetit janë të standarteve më të larta Europiane. Subjekti synon që të ushtrojë aktivitetin e tij në respekt të mbrojtjes së mjedisit dhe të nxitjes e shtimit të numrit të të punësuarve duke rritur biznesin e vet dhe duke sjellur përfitime ekonomike dhe rritjen e punësimit në zonën përreth. Subjekti synon që të zbatojë kërkesat dhe standartet më të mira sipas kërkesave të legjislacionit Shqiptar dhe standarteve ndërkombetare të kësaj industrie.

### **1.2. Informacion mbi Subjektin Deutschcolor Sh.a**

Subjekti është regjistruar në QKR (Qendra Kombëtare e Rregjistrimit) me nr Nipt. L213226504J, në dt. 26/01/2012 me aktivitet kryesor Import, eksport, tregtim llaçrash, përgatitje tullash, pajisje hidrosanitare, inerte, prodhime llaçrash të gatshme, të thatë, të parapërgatitura për ndërtim dhe rrugë, në thasë dhe rifuxho, me bazë çimento, allçie, bitumi, koll, llaç, fino, bojak, stuko, bojra sintetike e natyrore me bazë pigmentesh hekuri dhe atyre organike, prodhime me bazë silikatesh dhe përgatitje tullash, inerte të

**Deutschcolor sh.a**



granulomentrisë, punime të ndryshme të të gjitha këtyre materialeve, import, eksport i të gjitha këtyre. Subjekti kerkon te pajiset me Akt Miratimi per Leje Mjedisit Tipi B per aktivitetin “Prodhimi i preparateve veshese, llaqeve, bojrave dhe ngjitesve”.

Subjekti ka siguruar te gjitha kushtet e domosdoshme per ushtrimin e aktivitetit ekonomik.

Adresa: Durrës, Autostrada Tirane - Durrës, Km 30, godina DELTA, Nr.Pasurise 1/485, Zona Kadastrale 8515 dhe adresa Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19 Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796.

Administrator: Luan Muça

## **2. PLANIMETRIA E VENDNDODHJES SË PROJEKTIT**

### **2.1. Vendodhja e projektit:**

Objekti, Fabrika e re e Deutschcolor sha do te vendoset ne objektin me vendndodhje ne Durrës, Maminas, Vlashaj, Autostrada Tiranë – Durrës km 19, Zona kadastrale 3796.

Siperfaqja e prones:	17525 m <sup>2</sup>
Siperfaqja e gjurmes se struktures	7196 m <sup>2</sup>
Siperfaqja e ndertimit	10196 m <sup>2</sup>
Koeficienti i shfrytezimit	41 %
Zona Kadastrale	334 me nr pasurie 47, 48, 49, 52

Distanca nga kufiri i prones

Veri: 16.54 m

Lindje: 8.6

Jug: 20.56

Perendim: 11.13

Distanca nga Autostrada Tirane-Durrës

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al) dhe Cel: 0696032083

**Deutschcolor sh.a**



Nga trupi i rruges: 35 m

Nga aksi i rruges: 44.53 m

Fabrika eshte e projektuar ne disa zona:

- Mjedise te magazines per ruajtjen e lendeve te para,
- Magazina ku kryhen proceset e pergatitjes se bojerave,
- Mjediset ku etiketohet produkti final.
- Magazina te ruajtes se produkteve sipas tipeve te prodhimit.
- Mjedise te laboratorit per testimin e produktit dhe te lendeve te para.
- Zyrat per departamentin e shitjeve, te finances dhe departamentin e prodhimit.
- Mjedise per mbledhjet,
- Mjedise per nderrimin dhe ushqimit te punonjesve.
- Mjedise higjiene sanitare,
- Mjedise te parkimit te automjeteve te punes dhe te administrates.

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al) dhe Cel: 0696032083



Deutschcolor sh.a



Ne figurat e meposhtme tregohet vendndodhja e subjektit Deutschcolor sh.a.




Figura 1. Pamje nga google earth per vendndodhjen e aktivitetit.

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj, Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconstantal@gmail.com](mailto:aconstantal@gmail.com) ; web:  
[aconstantal.com.al](http://aconstantal.com.al) dhe Cel: 0696032083



Figura 2. Pamje e zmadhuar e vendit ku do te ushtrohet aktiviteti.

Vendodhja e objektit eshte ne koordinatat e meposhtme:

Tabela 1. Koordinatat e Vendndodhjes se fabrikes se Deutschcolor sha

Pika	x	y
1	4382885.77	4582786.55
2	4382843.20	4582930.36
3	4382932.82	4582919.97
4	4382955.96	4582796.16



## 2.2. Zonat e banuara

Vendndodhja ku kryhen aktivitetin e tij ekonomik Deutschcolor sha, eshte ne afersi te autostrades Tirane – Durres, km 19.

Nga ana e fasades kryesore te fabrikes se Deutschcolor sha, ndodhet autostrada kryesore qe te con nga Tirana ne Durres dhe anasjelltas.



Figura 3 dhe 4. Pamje e fadases kryesore e aktivitetit, nga aut. Tr- Dr.

Ne pjesen prapra fabrikes ndodhet toke are e pa shfrytezuar.



Figura 5 dhe 6. Fasada e pjeses se prapme te subjektit

Deutschcolor sh.a



Figura 7 dhe 8. Pamje e qe ndodhet ne krahe te majte te fabrikes duke u nisur nga hyrja kryesore per tek Deutschcolor sh.a



Figura 9. Pamje e godines ne te djathte te subjektit Deutschcolor sha

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconstantal@gmail.com](mailto:aconstantal@gmail.com) ; web:  
[aconstantal.com.al](http://aconstantal.com.al) dhe Cel: 0696032083

**Deutschcolor sh.a**



Distanca ndermjet deutschcolor me tokat perreth jepet me poshte:

Pjesa Veriore: 21.9 m

Pjesa Jugore: 39.5

Pjesa Lindore: 11.4 m

Pjesa perendimore: 21.9 m.

Objekti ku do vendoset fabrika e bojës është i vendosur në zonën industriale sipas planit urbanistik të ish komunes Maminas dhe të Bashkisë Shijak. Aktualisht njësia administrative e Maminasit është pjesë e Bashkisë Shijak.

### **3. INFORMACIONI PËR QENDRAT E BANUARA NË ZONËN KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI,**

#### **3.1. Popullata dhe demografia e Republikës Shqiperise:**

Shqipëria renditet e 136-ta në botë sipas popullsisë me një popullsi prej 2.87 milionë në vitin 2017. Dendësia e popullsisë është 101 banorë për km<sup>2</sup>. Jetëgjatësia e përgjithshme në Shqipëri në lindje është 78 vjet. Shkalla e fertilitetit total prej 1.80 fëmijëve për nënën është një nga më të ultat në botë. Në vitin 2016, popullsia e Shqipërisë ishte rreth 2,89 milionë, duke përfshirë 1,447 milionë meshkuj dhe 1,443 femra. Kishte 38,003 lindje të gjalla dhe 20,737 vdekje në Shqipëri. Rritja natyrore e popullsisë ishte pozitive, pasi numri i lindjeve tejkalonte numrin e vdekjeve me 17,266. Për shkak të migrimit, popullsia u ul me 18,307. Raporti total i varësisë i popullsisë në Shqipëri është 46.8%. Në vitin 2001, numri i ekonomive familjare arriti në 726.895. Struktura e moshës ishte nën 6 vjeç me 10.8% dhe 65 vjeç e lart me 7.5%. Megjithatë, raporti seksual arrin në 49.9% meshkuj dhe 50.1% femra të popullsisë së përgjithshme. Megjithatë, 2.737.614 të popullsisë ishin më të vjetër se 6 vjet. Në vitin 2011, popullsia

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al) dhe Cel: 0696032083

**Deutschcolor sh.a**




e përgjithshme ishte 2.831.741. Krahasimi tregon se popullsia është ulur me 7.7% në rreth 10 vjet. Rënia e emigracionit në shkallë të gjerë dhe pjellorisë supozohet të jenë shkaqet kryesore të rënies së popullsisë së vëzhguar. Një vlerësim paraprak i numrit të personave që refuzuan të merrnin pjesë në regjistrim ishte 29.355 (1.04 %). Kjo shifër bazohet në numrin e banesave për të cilat është regjistruar një refuzim dhe është përfshirë në popullatën e përgjithshme. Popullsia e përgjithshme përbëhet nga 1.421.810 meshkuj (50.2 %) dhe 1.409.931 femra (49.8 %). Për herë të parë në historinë e regjistrimit të popullsisë në vend, popullsia në zonat urbane është më e madhe se popullsia e zonave rurale. Sipas rezultateve paraprake të regjistrimit të vitit 2011, 53.7 % e popullsisë jeton në zonat urbane dhe 46.3 % në zonat rurale.

Sipas Institutit të Statistikave INSTAT, popullsia në vitin 2016 ishte 2,886,026. Qarku i Tiranës është zona me popullsinë më të lartë prej 811,649 në vend. Qarku i Fierit mbetet popullata me popullsinë e dytë më të lartë me një total prej 312,488. Qarku me rezultatin më të ulët janë Gjirokastrë, Kukës dhe Dibër respektivisht me 70,331, 84,035 dhe 134,153 banorë. Rreth 53.4% e popullsisë shqiptare që jeton në qytete. Tre qarqet më të mëdha përbëjnë gjysmën e popullsisë. Pothuajse 53.4% e popullsisë së Shqipërisë jeton në qytete. Si nga Instituti i Statistikave (INSTAT), tre qarqet më të mëdha përbëjnë gjysmën e popullsisë. Mbi 1 milion njerëz jetojnë në Tiranë dhe Durrës, duke e bërë atë zonën më të madhe urbane në Shqipëri. Kryeqyteti i Tiranës, është një nga qytetet më të mëdha në Gadishullin Ballkanik dhe renditet e shtata me një popullsi rreth 800,000. Pas saj është qyteti port i Durrësit, me një popullsi prej 201.110, e ndjekur nga Vlora, qyteti më i madh në Shqipërinë jugore, me 141.513 banorë.

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al) dhe Cel: 0696032083





Grafiku 1. Ndarja ne % e popullsisë ne Qytetet e Shqipërisë

Instituti i Statistikave parashikon që popullsia madje mund të rritet me më pak se një e pesta nga 763.560 deri në vitin 2011 në 909.252 deri në vitin 2031, varësisht nga shkalla aktuale e lindjeve dhe niveli i migrimit neto.

### 3.2. Popullata dhe demografia e Durrësit

Zona Gjeografike: Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Kurbin, në lindje me bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë. Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrimit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 517 banorë km<sup>2</sup> ndërsa sipas Regjistrimit Civil është 680 banorë



km<sup>2</sup>. Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.





Figura 10. Kufijt e qytetit te Durrësit.

Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparin e kësaj bashkie si zonë turistike, pasi përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë gjiri i Lalëzit si dhe Kepi i Rodonit, të cilat deri tani kanë qenë pjesë e komunave Ishëm, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull. Durrësi ka gjithashtu portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë njëjën më të rëndësishme tregtare në vend.

Grafiku 2. Te dhenat mujore te temperaturave ne Durres



Harta e re territoriale e Bashkisë Durrës



Figura 11. Harta e re territoriale e Bashkisë Durrës

Deutschcolor sh.a



Shijaku kufizohet në veri, perëndim dhe jug nga bashkia Durrës dhe në lindje nga bashkitë Vorë dhe Tiranë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shijakut.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Shijaku numëron një popullsi prej 27,861 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron 44,103 banorë. Me sipërfaqe prej 92.19 km<sup>2</sup>, ajo ka densitet prej 302 banorë/km<sup>2</sup> sipas censurit dhe 478 banorë/km<sup>2</sup> sipas regjistrit civil. Bashkia e re përbëhet nga katër njësi administrative të cilat janë Shijaku, Maminasi, Xhafzotaj dhe Gjepalaj. Të gjitha janë pjesë e Rrethit Durrës të Qarkut Durrës. Bashkia e re ka një qytet dhe 25 fshatra. Lista e plotë e qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie është si më poshtë:

Tabela 2. Te dhena per popullsine ne Bashkine Shijak

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqe KM <sup>2</sup>
Durrës	Qyteti Shijak	<b>Shijak</b>	Qyteti Shijak	34,513	44,103	92.19
		<b>Maminas</b>	Fshatrat: Maminas, Karreç, Vlashaj, Karpen, Bodinak, Metallë, Bilalas, Rubjek			
		<b>Xhafzotaj</b>	Fshatrat: Xhafzotaj, Pjezë, Rreth, Sallmone, Koxhas, Borake, Guzaj, Vllazërimi			
		<b>Gjepalaj</b>	Fshatrat: Gjepalaj, Hardhishtë, Çizmeli, Eminas i Vogël, Likesh, Kënetë, Shtrazë, Shahinaj, Shetël			

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj, Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al) dhe Cel: 0696032083

Harta e re territoriale e Bashkisë Shijak




Figura 12. Harta e re territoriale e Bashkisë Shijak

### 3.3. Aktivitete Ekonomike perfshi aktivitetet kryesore qe zhvillohen

Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manifakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit. Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit. Në qytetin e Durrësit zhvillohen shume sektore te aktiviteteve ekonomike nder te cilat mund te permendin Sektori I Bujqesise, Sektori I Industrise, Sektori I Ndertimit, Sektori I Transportit, Sektori I Tregtise, Sektori I Turizmit dhe Sektori I Sherbimeve.

Orientimi I aktiviteteve kryesore ekonomike te qytetit te Durrësit




Grafiku 3. Shperndarja ne % e aktiviteve ekonomike ne Durres.

Durrësi është gjithashtu një zonë e rëndësishme arkeologjike, pasi nën qytetin aktual gjenden disa shtresa qytetërimesh antike. Zbulimet arkeologjike janë të shumta, ndërsa ndërtimet e dekadave të fundit kanë dëmtuar një pjesë të kësaj trashëgimie.

Me mbi 5600 aktivitetet ekonomike të tij dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi është renditur në vendin e dytë si ekonomia më e fortë e vendit, pas Tiranës.

Te dhena për kompanitë e huaja të cilat kanë ardhur për të zhvilluar aktivitetin e tyre ekonomik në qytetin e Durrësit.





Grafik 4. Shperndarja e ekonomive te huaja ne Durres

Turizmi veror dhe kulturor është një industri me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Durrësit. Me mbi 750.000 vizitorë në vit, kjo është zona më e rëndësishme e vendit në lidhje me turizmin masiv. Sipas Zyrës Rajonale të Punës të Durrësit, forcat aktive për të punuar llogariten rreth 54,000 njerëz. Niveli i të papunëve për rrethin e Durrësit shkon në rreth 10,38%, ku papunësia është më e përhapur te femrat. Sektori privat ka punësuar rreth 31,3%, i ndjekur nga sektori bujqësor privat me 36,7%, dhe sektori shtetëror me 21,3%. Durrësi është një nga zonat më problematike sa i përket furnizimit me ujë, për shkak se burimet ujore aktuale janë të kufizuara dhe gjenden në distancë të largët, ndërsa bashkia e re nuk ka në afërsi të saj burime të tjera të pastra për shtimin e furnizimit me ujë. Ndërtimet pa kriter kanë mbingarkuar infrastrukturën aktuale urbane si kanalizimet e ujërave të ndotura, rrugët apo parkingjet publike si dhe rrezikojnë të dëmtojnë të ardhmen turistike të qytetit. Pavarësisht mbingarkimit të zonës aktuale urbane me ndërtime, zgjerimi i bashkisë me komunat përgjatë bregut të detit krijon një sfidë të mëtejshme, pasi edhe Gjiri i Lalzit ka filluar të sulmohet për ndërtime me apo pa leje. Balancimi i nevojës për zhvillimin e turizmit me nevojën për të ruajtur një mjedis të pastër dhe kthimi i turizmit në një aktivitet të qëndrueshëm është sfida kryesore e

bashkisë së re. Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme në zonat e urbanizuara gjatë dy dekatave të fundit si dhe ndërtimi i impianteve të përpunimit të ujërave të zeza për të shpëtuar ndotjen e bregdetit konsiderohen sfida me rëndësi të veçantë. Gjatë viteve të fundit, në qytetin e Durrësit janë krijuar lidhje rrugore me daljen e qytetit, të cilat sërish janë të pakëta për të përballuar fluksin. Lidhja me transport publik të fshatrave përbërëse të bashkisë së re me qytetin e Durrësit është një zgjidhje që shërben njëkohësisht për turizmin si dhe për vetë banorët. Shtrirja e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin e bashkisë së re është e domosdoshme veçanërisht për shkak se një pjesë e bregdetit si Kepi i Rodonit është i ngopur me mbetje plastike të sjella nga lumenjtë. Zhvillimi i bujqësisë në zonat rurale përreth bashkisë aktuale është një mundësi, veçanërisht sa i përket produkteve ushqimore të specializuara në shërbim të tregut turistik.

Shijaku është një qytet i pasur me burime ujore, ekonomia në vend është e orientuar kryesisht tek tregtia, industria fasone dhe ajo përpunuese e prodhuese. Firmat private numërohen 263 subjekte nga të cilat 17 klasifikohen si biznes i madh dhe 246 si biznes i vogël.

Këto biznese operojnë kryesisht në fushën e shërbimeve, tregtisë dhe më pak në fushën e prodhimit dhe ndërtimit.

Ne dy tabelat 3 dhe 4 ne vijim jepen te dhena ekonomike

Tabela 3. Sipërmarrja dhe biznesi, 2014

	Publik	Privat	Shuma	Biznese private	Biznes i madh	Biznes i mesëm	Biznes i vogël
<b>Gjepalaj</b>	0	41	41	41	6	7	28
<b>Maminas</b>	20	132	152	132	22	32	78
<b>Shijak</b>	73	500	573	500	83	124	293
<b>Xhafzotaj</b>	46	569	615	569	116	139	314

Tabela 4. Bizneset private sipas sektorëve, 2014


	Biznes i madh	Prodhim	Ndërtim	Biznes i mesëm dhe i vogël	Transport	Hoteleri Shërbime	Bujqësi Peshkim
<b>Gjepalaj</b>	6	4	2	35	4	25	6
<b>Maminas</b>	22	18	4	110	8	98	4
<b>Shijak</b>	83	63	20	417	66	345	6
<b>Xhafzotaj</b>	116	66	40	453	62	383	8

Ne zonen përrreth objektit ku do vendoset fabrika e bojës në Maminas mëqenese është një zonë industriale prej vitesh janë të vendosura dhe zhvillojnë aktivitetin një sërë objektësh dhe aktivitete ekonomike, industriale, të shërbimeve bare e restorante, tregëtimit të materialeve, prodhimit të materialeve të ndërtimit, grumbullimit të bimeve mjeksore aromatike, pulari dhe barake të përgatitjes së embelsirave, pika të tregëtimit të gazit dhe të karburanteve, etj. Në një distancë nga 20 m deri në 1000 m në zonen rreth objektit ku do të instalohet fabrika e bojës gjendet një fabrike tullash, dy fabrika të përpunimit të bimeve mjeksore, dhjetra restorante në të dyja anët e autostradës, fabrike e prodhimit të embelsirave, pulari me mbi 20,000 shpend, disa pika tregëtimit karburante dhe një pike tregëtimi gazi, pika servisi makinash dhe pjese këmbimi, pika të grumbullimit të makinave të vjetra, pika të tregëtimit të automjeteve të përdorura, pika të tregëtimit të materialeve të ndërtimit. Konkretisht objekti ndodhet në zëmër të gjithë këtyre aktiviteteve të sipërpermendura.

#### 4. SKICAT/PLANIMETRITË E OBJEKTEVE/STRUKTURAVE TË PROJEKTIT;

##### 4.1. Përshkrimi i vendndodhjes së instalimit

Subjekti Deutschcolor sha në vitin 2014 është bërë pronar i tokës mbi të cilën është ndërtuar objekti ku do të instalohet fabrika për prodhimin e bojërave. Objekti është ndërtuar gjatë viteve 2015-2017. Më poshtë po japim me detaje disa skica të planimetrise dhe të vendosjes së objektit ku do të instalohet fabrika e bojës së Deutschcolor sha.

<p><b>Deutschcolor sh.a</b></p>	
---------------------------------	--

<p>Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19 Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796</p>	<p>Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania email: <a href="mailto:aconultantal@gmail.com">aconultantal@gmail.com</a> ; web: <a href="http://aconultant.com.al">aconultant.com.al</a> dhe Cel: 0696032083</p>
---	--

Deutschcolor sh.a



Figura 13. Planimetri e pergjithshme e aktivitetit

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796


Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al) dhe Cel: 0696032083




Deutschcolor sh.a



PAMJA LINDORE



PAMJA VERIORE



Luan Muça



PAMJET / A	1:500	A. MAMU A-8756/1
		02/2
LE.E. ZIVILLIPI		01/01/2017
A_031_02_a3 12		Komuna MAMINAS

Figura 14. Pamjet e jashtme te subjektit.


Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconstantal@gmail.com](mailto:aconstantal@gmail.com) ; web:  
[aconstantal.com.al](http://aconstantal.com.al) dhe Cel: 0696032083

Deutschcolor sh.a



## PAMJA JUGORE



## PAMJA PERENDIMORE



Luan Muça



PAMJET / B		A. PAMJET / A-02/1
1:800		02/2
L.E.K. DOKUMENTE		03/1/2017
A 031 01	a3 11	Komuna MAMINAS

Figura 15. Pamjet e jashtme te subjektit.


Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconstantal@gmail.com](mailto:aconstantal@gmail.com) ; web:  
[aconstantal.com.al](http://aconstantal.com.al) dhe Cel: 0696032083

Deutschcolor sh.a



PRERJA A-A



FABRICA E PROJEKTIMIT TE BLOKUT DUTSCHCOLOR MAMINAS

ARCHITECTS

PRERJA A-A

1:250

L.L.B. ZHIVILJIMET

A 021 03 a3 10

A. 154/902 4-075/1

02/27

02 01/2017

Komuna MAMINAS

Figura 16. Prerja A-A pamjes se ndertesës.

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconstantal@gmail.com](mailto:aconstantal@gmail.com) ; web:  
[aconstantal.com.al](http://aconstantal.com.al) dhe Cel: 0696032083





Zonat kryesore te objektit ku do te vendoset fabrika e bojës, te cilat do te perdoren nga punonjesit jane:

1. Zyrrat e administrates;
2. Salla e mbledhjeve dhe e pritjes se klienteve;
3. Dhomat e nderrimit dhe te ushqimit te punonjesve;
4. Mjedise higjieno-sanitare.

## **5. PËRSHKRIMI I PROCESVEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE**

### **5.1. Pershkrimi dhe organizimi i punes per aktivitetin “Prodhimi i bojërave dhe Ilaqeve”.**

Megenesese objekti ku do te vendoset aktiviteti “Prodhim i bojërave” eshte i perfunduar ne kete raport nuk do te pershkruahen proceset ndertimore.

Ne lidhje me pershkrimin e proceseve teknologjike, subjekti Deutschcolor sh.a ka marre eksperincat me te mira dhe eshte munduar ti implementoje ato ne aktivitetin e tij. Subjekti Deutschcolor sha do te prodhoj dy lloje produkte kryesore me paketim me vellime te ndryshme te cilat jane:

- 1-Bojerat me baze solventi (vaji) dhe
- 2-Bojerat me baze uji;

Subjekti do te ripaketoj ne ene nje litershe treset white spirit qe perdoret si hollues per bojerat me baze solventi.

*a-Lendet e para:*

1-Per bojerat me baze solventi (vaji) lendet e para qe perdoren jane:

- BUTYL ACETATE (Solvent),
- DESMODUR HLBA (rezine),
- DESMODUR IL 1351 BA (rezine),



**Deutschcolor sh.a**



- DESMODUR L 75 (rezine),
- ETHYL ACETATE (Solvent),
- GLICEXTER 3097 X 60 (rezine),
- IZELKYD MO 49 X 70 (rezine),
- WHITE SPIRIT,
- XYLENE,
- OMYA CARB 3-TN substance mbushese.

Sasite e perdorimit vjetor jane ne varesi te kerkeses se tregut per bojera.

2-Per bojerat me baze uji lendet e para jane:

- ANFOAM S (Agjent antishkumues),
- APT CODIS 95 (stabilizant),
- BAYFERROX 130 (pigment pluhur),
- CELULOZE XM 20.000 PV (celuloze),
- CELULOZE XM 3.000 PV (celuloze),
- CRILAT 4724 (rezive vinavil),
- OMYA CARB 1-TN Filler, OMYA CARB 5-TN substance mbushese,
- PROPYLENE GLYCOL TECH,
- TEXANOL ESTER ALCOHOL.

Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconultantal@gmail.com](mailto:aconultantal@gmail.com) ; web:  
[aconultant.com.al](http://aconultant.com.al) dhe Cel: 0696032083

*b-Materialet ndihmese dhe efienca e perdorimit te energjise.*

Per procesin e prodhimit dhe te tregtimit te produktit perdoren lende ndihmese te tilla si:

- Nafta qe harxhojne mjetet e transportit per transport te lendeve te para dhe produktit final.
- Energjia elektrike sherben per venien ne pune te makinerive dhe pajisjet te cilat punojne per prodhimin e bojerave. Energjia elektrike sherben gjithashtu per ndricimin e mjediseve te jashtme te brendshme dhe te jashtme, per administraten (kompjuterat, kondicioneret, pajisjet e kafes, etj).

c- Realizimi i punes kryhet ne disa stade te shprehura si me poshte.

*1-Sigurimi i lendeve te para*

Lendet e para per prodhimin e bojerave sigurohen te gjitha nga importi nga vende te bashkimit europian si Gjermania, Greqia, Italia, etj. Jane materiale te certifikuara me sigurine me te larte dhe rrezikshmerine me te ulet.

*2-Linja teknologjike e prodhimit te bojerave*

Linjat e prodhimit dhe procesi i prodhimit te bojerave eshte nje proces i thjesht qe konsiston ne perzjerjen e lendeve te para sipas nje recepture te caktuar te cilat ne perfundim te procesit perfitojne produktin ne mas. Mbas kesaj produktet amballazhohet ne ene te ndryshme me volume te ndryshme kryesisht ne kova plastike te cilat jane te etiketuara paraprakisht. I gjithe procesi eshte i mbyllur dhe i mekanizuar. Roli i punonjesve eshte kryesisht ne venien ne pune dhe komandimin e makinerive dhe pajisjeve. Pajisjet qe perdoren per prodhimin e bojerave jane te Oliver Batlle dhe menyra e funksionimit te tyre pershkruhet si me poshte vijon.

*Per bojerat me baze solventi (vaji).*

Procesi teknologjise se prodhimit te poliuretaneve fillon me vendosjen e enes se prodhimit ne peshoren elektronike per te hedhur lenden e pare dhe me pas futet per

ciklin e pare te perzieries VRF18. Pasi dozohen ne menyre automatike shtohen dhe perzihen aditivet. Me pas procesi I prodhimit ne mikserin e II basket mill Millenium, i cili eshte i perbere nga mikrosfera dhe ka funksionimim e mullirit ne menyre qe llaku te bluhet nen 10 mikron. Ky proces zgjat per 45 min dhe ky mikser ben te mundur bluarjen dhe njekohesisht ruajtjen e temperatures se aparatures konstante pasi eshte i veshur nga nje sistem ftohje me uje per te penguar rritjen e temperatures. Me pas kalohet perseri ne mikserin VRF 18 per te bere perzierjen perfundimtare. Pasi perftohet produkti perfundimtar filtrohet me ane te makinerise se filtrimit MF8 i cili eshte I perbere nga sita deri ne 60 mikron dhe pasi filtrohet fillon mbushja automatike e produktit ne paketim alumini. Ngjitja e etiketave behet me dore.



Figura 19. Pamje e pajsjes Oliver Battle

Per bojerat me baze uji.

Procesi I teknologjise te prodhimit te bojrave te ujit fillon me ngarkimin ne mikserin e madh I cili eshte I vendosur mbi peshoren elektronike te ujit dhe rezinave. Me pas nepermjet shnekut ngarkohet e gjithë lenda e produktit te ngurte e cila transportohen ne Mikserin e madh (ku me pas behet perzierja). Ky mikseser eshte I perbere nga nje skrab i madh I cili mund te beje levizje rrethore duke mos lejuar ngjitjen e produkteve ne muret anesore te tij dhe gjithashtu ka nje disk qendror I cili mund te beje levizje vertikale duke realizuar ne kete menyre homogjenizimin e lendes se pare. Me pas shtohen aditivet ne menyre manuale dhe pasi ka mbaruar procesi I prodhimit  $5m^3$  (5000Lt). I gjithë produkti transferohet me ane te nje pompe pneumatike ne nje ene me kapacitet  $10m^3$  per rreth 15 min. Pasi transferohet ne enen e madhe e cila eshte e perbere nga nje disk perzieres me shpejtesi me te vogel, ne mikserin  $5m^3$  fillon procesin e prodhimit te ciklit te dyte nderkohe me anen e linjes automatike Flash 20 bejme te mundur mbushjen e produktit neper kova. Kapaciteti mbushes varion 1-20 lt dhe me pas kovat meren manualisht dhe vendosen ne paleta.

3- Linja e formimit te kovave plastike me pajisjen HURMAK

Subjekti Deutschcolor sha, bene procesin e formimit te kovave plastike qe perdoren per ambalazhimin e bjerave me baze uji. Perfitimi i kovave behet nga perdorimi i granulave plastike dhe ngjyruesve te ndryshem. Per te kryer procesin e formimit te kovave subjekti ka blere edhe nje pajisje te quajtur Hurmak, e cila sherben per formimin e kovave te plastikes ne vellime 3, 10 dhe 15 litra.

Hurmak eshte e perbere nga 2 makineri dozative me injektim me force shtytese 500 ton dhe 300 ton, dhe nga 2 robot te cilet bejne te mundur heqien e koves dhe venien e etiketave. Lenda e pare dozohet automatikisht se bashku me pigmentin ne stampen dhe me pas roboti vendos etiketen duke mare keshtu koven perfundimtare.

Te dy keto makineri jane te lidhura me 6 stampa duke patur mundesine e prodhimit te 3 lloj kovave 3,10,15 L si dhe 3 lloj kapakeve 3,10,15 L. Pasi eshte dozuar granulat plastike dhe pigmenti ne makinerine qe preson deri ne 500 ton prodhohen kova 10 L dhe 15L. Roboti ne menyre automatike nga magazina e etiketave e merr ate duke e mbeshtjelle ne kove ne menyre qe kova te vishet plotesisht dhe te injektohet materiali brenda saj. Me pas stampa mbyllet per nje periudhe 10-15 sek dhe perpara se te hapet, ftohet ne menyre te menjehershme nga ftohesi. Serpentinat e ujit ulin temperaturen dhe bejne te mundur realizimin e koves. Pastaj vjen perseri roboti duke hequr koven e prodhuar dhe duke lene etikete per koven e radhes. E njejta menyre prodhimin ndodhe edhe ne makinerine qe preson deri ne 300 ton ku prodhohen kapaket 3,10,15L si dhe koven 3 L . Gjithashtu linja eshte e pajisur me nje makineri grirese “Crasher” e cila bene te mundur grirjen e produkteve skarco. Keto materiale te grira jane 100% te rickliushem dhe rifuten ne proces per tu bere kova ose kapake duke e bere procesin 100% te mbyllur pa asnje % humbje. Materiali qe perdoret si lende e pare per te prodhuar kovat jane granula plastike dhe quhet polypropylene (eshte i paster).



Figura 20. Pamje e pajisjes HURMAK

#### 4-Laboratori dhe testimi i produktit final.

Kompania kryhen teste per te percaktuar parametrat e produktit te perftuar per kete nje laborator te vendosur ne mjedise te ndara. Ne laborator kryhen testet e nevojshme per produktin.



Figura 21. Pamje te labororit te Deutschcolor sh.a

#### 5-Produkti final

Aktualisht si produkt final eshte paktetuar sipas perberjes ne:

- Kova te bojerave me baze uji ne vellimet 3 l, 5 l, dhe 10 l.
- kutit e bojerave te pergatitura me baze solventi ne vellimet 500 ml, 750 ml, 1 l dhe 1.5 l.

Kompania ripaketon ne format 1 l wihite spirit qe eshte nje hollues per bojerat me baze solventi. Produktet tregtohen ne te gjitha pikat e autorizuara (dyqanet ne Tirane dhe rrethe) nga Deutschcolor sh.a.



Deutschcolor sh.a



Per te garantuar cilesine e produktit me te mire ne treg subjekti eshte pajisur me certifikata per Sistemi i menaxhimit ISO sipas 9001:2015 per:- “Projektim, prodhim dhe shperndarje bojrash dhe llaqesh”, nga TUV NORD CERT



Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19  
Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconultant@gmail.com](mailto:aconultant@gmail.com) ; web:  
[aconultant.com.al](http://aconultant.com.al) dhe Cel: 0696032083


<b>Deutschcolor sh.a</b>	
--------------------------	--

Figura 22. Certifikata per Sistemi i menaxhimit ISO sipas 9001:2015  
Sistemi i menaxhimit ISO sipas 14001:2015 per:- “Projektim, prodhim dhe shperndarje bojerash dhe llaqesh” nga TUV NORD CERT.



Figura 23 dhe 24. Certifikate e sistemit te menaxhimit ISO

<p>Adresa: Durrës, Maminas, Vlashaj, km 19 Autostrada Tiranë - Durrës, Zona kadastrale 3796</p>	<p>Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania email: <a href="mailto:aconstantal@gmail.com">aconstantal@gmail.com</a> ; web: <a href="http://aconstantal.com.al">aconstantal.com.al</a> dhe Cel: 0696032083</p>
---	--

## 6. INFORMACIONI PËR INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME

### 6.1. Lidhja e zones me rruge

Subjekti ndodhet ne afersi te autostrades Tirane – Durres ne km 19. Vendndodhja ne Maminas eshte ngjitur me autostraden Tirane-Durres. Per me teper, distanca e objektit ku do te vendoset fabrika e bojës nga Autostrada Tirane-Durres eshte si me poshte:

Nga trupi i rruges: 35 m

Nga aksi i rruges: 44.53 m

Subjekti ka ndertuar nje segment prej 200 m rruge dytesore me autostraten per te siguruar hyrjen ne fabrike dhe daljen e sigurt te automjeteve ne autostrade ne drejtimin Tirane - Durres.



Figura 25 dhe 26. Pamje e afersise me rrugen kryesore te subjektit Deutschcolor sh.a

### 6.2 Lidhja me rrjetin elektrik

Subjekti Deutschcolor Sh.a furnizohet me energji nga OSHE nepermjet nje linje te deikuar qe merret nga rrjeti ekzistues i zones. Energjia elektrike perdoret per venien ne pune te pajisjeve dhe makinerive qe perdoren ne procesin e perftimit te produktit, ndricimin e mjediseve te jashtme te aktivitetit, per zyrat, si edhe per sistemin e aspirimit te mjediseve te punes.



Figura 27. Kabina elektrike e vendosur ne ambientet e subjektit

### 6.3 Furnizimi me uje

Subjekti aktualisht ujin e siguron me autobote nga pale te treta deri ne lidhjen me sistemin e furnizimit me uje te zones ose do gjej zgjedhje te tjera. Sasite ditore te konsumit te ujit shkojne deri ne 10 m<sup>3</sup> nga ku vetem 2 m<sup>3</sup> perfundojne ne impjantin e trajtimit te ujerave te perdorura. Deutschcolor sha e perdore ujin per procesin e prodhimit te bojerave me baze uji, per qellime higjieno-sanitare dhe per pastrimin e mjediseve te jashtme dhe te brendshme te subjektit.

#### **6.4 Sistemi i kanalizimit te ujerave te perdorura**

Per mbledhjen e ujerave te perdorura per pastrimin e ambienteve te punes subjekti ka ndertuar nje grope dekantimi e cila do te sherbejne per trajtimin e ujerave dhe me pas shkarkimin ne kanalin kullues qe kalon ne afersi te subjektit Deutschcolor sha.

Kompania nga zhvillimi i aktivitetit nuk pritet te kete ndikime negative ne sistemin e kanalizimeve te Njesise Administrative Maminas.

#### **6.5 Rruget ekzistuese**

Perpara aktivitetit te fabrikes Deutschcolor sha eshte rruga kryesore qe te con nga Tirana per ne Durres dhe anasjellatas. Ndersa anash subjektit territori eshte toke are. Prapa fabrikes eshte rruge nje kalimshe e vjeter ne cilen subjekti planifikon per ta rregulluar, duke pastruar kanalet per te krijuar drenazhimin e rruges, si dhe duke e shtruar rrugen me cakull dhe ne nje moment te dyte mendon qe ta asfaltoje.

Tabela 5. Karakteristikat e mjedisit ku zhvillohet projekti

1. Tipare te mjedisit lokal qe mund te ndikohen nga projekti -Nuk ka zona te mbrojtura per specie te vecanta -Nuk ka ne afersi vende te perdorshme nga publiku -Nuk ka problem me trafikun e rruges lokale/nacionale
2. Projekti zhvillohet ne nje zone e cila ne afersi ka aktivite te tjera industriale.
3. Zona ku zbatohet projekti eshte pjeserisht e zhvilluar.
4. Perdorime ekzistuese te tokes qe mund te ndikohen nga projekti Subjekti do permiresoje peisazhin ne harmoni me mjedisin perreth.
5. Zona nuk ka plane te perdorimit te tokes per qellime te tjera.
6. Synohet te nxitet levizja e popullates te shtresave te ndryshme.
7. Nuk paraqitet rreziku I demtimit te veprave ujore, nuk cenon sektore te peshkimit,

turizmit, bujqesise, pyjeve pasi nuk ndeshen ne afersi te zones se zhvillimit te aktivitetit.

8. Objekti ndodhet ne zonen industrial te Maminasit dhe behet pjese e kesaj zone.

9. Mbeshtetur ne studimet e kesaj zone, zona nuk eshte me terren rreshqites, e ndikuar nga fenomenet e erozionit dhe termeteve. Krahas masave per gjelberimin e zones, do zbatohen ne menyre rigoroze kerkesat per sistemime per te evituar erozionin.

10. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk shoqerohet me ndryshime fizike te perberesve te mjedisit, me veprimtari qe emetojne ndotes e ndikojne ne ndryshime te mikroklimes, ndryshime gjeologjike, ndryshime ne topografine zonale apo te perdorimit te tokes.

11. Aktiviteti nuk shoqerohet me emetime te demshme. Ndikimet nga zhurma, vibracione jane te paperfillshme. Subjekti monitoron periodikisht nivelin e zhurmave, pluhurit, PM10, gazeve dhe ujerave te perdorura per qellime te raportimit mjedisor dhe sigurine dhe shendetin ne pune.

